



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR**

VENDIM NR 48 Datë 11.10.2021


Mbështetur në ligjin Nr.139 date 17.12.2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 54 pika m,si dhe ne V.K.M nr.929 date 17.11.2010 “Per krijimin dhe përdorimin e fondit të vecantë ”, pika 2/a .Keshilli Bashkiak në mbledhjen e rradhës me kerkesen e propozuar keshilltari Astrit Ademi dhe mbeshtetjen e keshillit Keshilli Bashkiak ne piken te ndryshme, datë 11.10.2020 me 17 vota pro 0 vota kundër.


Vendosi :

1. Nga Buxheti i Keshillit t'i jepet ndihmë financiare në masen e nje page shperblim Znj.Fitnete Spahiu për rezultate të mira në pune.
2. Me zbatimin e ketij vendim ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtoria Ekonomike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar Këshilli

Sokol Sava





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.980/1.prot.

Peshkopi, më 21.10.2021

Lënda : Kthim vendimi pa veprim

Drejtuar : BASHKISE DIBER

PESHKOPI

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, date 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 16, pasi verifikova për efekt ligjshmërie vendimin e Këshillit të Bashkisë Diber nr.48, date 11.10.2021 "Për ndihmë financiare në masën e një page shperblim për punonjësen e Bashkisë znj.Fitnete Spahiu", konstatove se Këshilli i Bashkisë nuk gëzon asnjë të drejtë të shpërblejë punonjësit e Bashkisë, për pasojë vendimi verifikimi dhe shqyrtimi kthehet pa veprim pasi bën pjesë në kategorinë e akteve absolutisht të pavlesfshme të percaktuara në nenin 108 të ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i RSH".

